



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005630-9/26, dt. 10.02.2026
Mitrovicë

02-060/01-0005630-9/26
Data: 10.02.2026
Shtet: Republika e Kosovës

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë dhe komiteteve tjera; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit

1. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit.
2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 - 2.1 Ferdi Kadriu,
 - 2.2 Arton Berisha
 - 2.3 Bajram Istrefi,
 - 2.4 Blerta Çeliku, dhe
 - 2.5 Arisa Miftari
3. Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
 - 3.1 Të këshillojë dhe konsultohet me drejtoritë: Planifikimit, Urbanizmit, Gjcodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Bujqësisë dhe Mbrojtjes e Ambientit;
 - 3.2 Të përcjell zhvillimin e planit rregullues;
 - 3.3 Shqyrtimi i çështjes në lidhje me transportin publik dhe propozimet strategjike për magjistralet;
 - 3.4 Të përcjell çdo çështje që ka të bëjë me ndërtimin, procedurat e vendosjes së qoshqeve, reklamave (panove);
 - 3.5 Të kontrollojë procedurat për zbatimin e planifikimit, vërejtjet për ndalim dhe urdhrat për rrënim;
 - 3.6 Të ushtrojë mbrojtjen dhe kontrollin e ndërtesave me interes arkitektonik apo historik;
 - 3.7 Të ndihmojë në ruajtjen e ambientit, parandalimin e ndotjes ambientale të ajrit, tokës dhe ujit;
 - 3.8 Përcjell mirëmbajtjen e parqeve, fushave rekreative dhe të argëtimit, shëtitoreve publike, hapësirave të hapura publike të Komunës;
 - 3.9 Të mbështes zhvillimin e ardhshëm të Komunës; dhe
 - 3.10 Përbrenda vijë-veprimeve të vendosura dhe vlerësimeve të miratuara të Kuvendit, t'i rekomandohet Kuvendit për vetësimi apo dhënia nëpërmes blerjes, shitjes, lëshimit me qira, licencimit apo dhurimit të tokës apo objektit, ose në interesat dhe të drejtat në lidhje me tokën.
4. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit i dorëzon Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës së tyre për shqyrtim dhe miratim.
6. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet: 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të komitetit



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI